




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.rks-gov.net/gjilan, tel.0280 320 781, 0280 320 782, 0280 321 482, 0280 321 486

Në bazë të dispozitave të nenit 12.2.d. nenit 14.2. dhe nenit 17. pika c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 7. par. 1. dhe 2. të Ligjit nr.04/L045 për Partneritetin Publiko Privat, dhe nenit 38.par. 1. pika 1.1., 1.2., dhe 1.3., nenit 39 par.1 pika.1.4. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e vet të mbajtur më datën: 06.04.2012. 2012, miraton këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR HYRJE NË PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT

(Lokacioni të ish Magjistranja)

Neni 1.

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objekteve përmes Partneritetit Publiko-Privat (në tekstin e mëtejshëm PPP) të: * Ndërtesës Banimore-Afariste, Institucionit parashkollor-Qerdhës së fëmijëve, dhe rregullimi i përmabjtjeve tjera përcjellëse të objekteve të infrastrukturës teknike komunale: parkingut, këndit të lojrave për fëmijë, hapësirës gjelbëruese etj), në parcelat si në vijim:
1. parcela nr. 2438-1 në s=1600m², vendi i quajtur:" Monopl te Spitali", ZK- Gjilan, Qert.Pronës, nr. 1750, P.SH.e Kuvendit të Komunës Gjilan,
 2. parcela nr. 2438-2, në s=1916m², vendi i quajtur:" Monopl te Spitali", ZK- Gjilan, Qert.Pronës, nr. 1750, P.SH.e Kuvendit të Komunës Gjilan,
 3. parcela nr. 2438-4, në s=419m², vendi i quajtur:" Monopl te Spitali", ZK- Gjilan, Qert.Pronës, nr. 1750, P.SH.e Kuvendit të Komunës Gjilan,
 4. parcela nr. 2437-7, në s=987, vendi i quajtur: monopol-Tregu i Kafshëve", ZK-Gjilan, Qert.Pronës nr. 2611 P.SH. Shoqata e Zjarrfiksave-Gjilan,

Neni 2.

Autorizohet Autoriteti Kontraktues i KK-ës Gjilan, që përmes Shërbimit të prokurimit, të përgadisë dhe zbatoj procedurat e ofertimit dhe të parakualifikimit, të hartoj draftmarëveshjen, të hartoj raportin me shkrim të Analizës së Përfitimeve dhe Shpenzimeve të veqanta të projekteve konkrete dhe KK-ës Gjilan, të i propozoj miratimin e Vendimit për parapërzgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm për realizimin e projekteve për lokacionet nga neni 1. e këtij Vendimi.

Neni 3.

Pjesë përbërse e këtij Vendim është edhe Vendimi për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike të pjesës së PRRU: "Kodra e Thatë" në Gjilan (Stacioni i Autobusëve" Kosovatrans-Rr. Gjon Sereqi"), 01.nr.12074 i dt. 12.10/2009.

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e Miratimit.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, përmes Drejtorisë për Urbanizim dhe Mbojtje të Mjedisit si dhe Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastrë, Pronë dhe Banim të KK-ës Gjilan.

01.Nr. 16-38214
Gjilan, më: 06.04.2012

Kuvendi I komunës,

Izmi Zeka, Kryesues